



Duke u bazuar në nenin 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale lidhur me nenin 40 pika 40.2 nën J), nenit 10 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit për dhenje në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së palujtëshme të komunës Nr04/L-144, neni 20 paragrafi 3 pika 3.1 nën 3.1.3 si dhe paragrafit 5, 6 dhe 7 të Rregullores së QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhenjës në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së palujtëshme të komunës, nenit 40 të Statutit të Komunës si dhe duke ju referue Shkresës së Kryeministrit Ref.Nr.163/10 të datës 06.04.2010, Shkresës Ref.Nr.EU-RRK-IV të dt. 17.03.2016 të Organizatës Ndërkombëtare për Migrim në Kosovë si dhe Shkresës së Ministrisë për Komunitete dhe Kthim në Prishtinë Nr.1264/2 të dt. 23.05.2016, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e V-të të rregullt për vitin 2016, të mbajtur më 27.05.2016, miratoi këtë:

V E N D I M

Për

Dhenjën në shfrytëzim të pronës komunale afatgjatë për 40 vjet për ndërtimin e shtëpive të banimit për komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptas të rikthyer

I

1. Miratohet , kërkesa e QRKS-e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim nr.1264/2 dt.23.05.2016 që ka të bëjë më ndarjen e tokës për komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptas për të kthyerit, kërkesës së EU-RRK-IV dhe Organizatës Ndërkombëtare për Migrim –IOM në Prishtinë, Ref. Nr.01-353-896/16 e dt. 18.03.2016 si dhe kërkesës së Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, për dhenje në shfrytëzim të pronës së komunës për ndërtim të 4 shtëpive për të rikthyerit nga Republika e Malit të Zi.
2. Jepet në shfrytëzim afatgjatë për 40 vite toka komunale parcela kadastrale nr.733-5 në sipërfaqe prej 1004 m katror në Klinavc me kulturë kullos e klasës së 5 në vendin e quajtur Arrishtë.
Toka në pronësi komunale e cekur në kuadër të kësaj pike jepet pa kompensim.
3. Specifikimi dhe skicimi i Planit realizues urbanistik së bashku me Listën e familjeve përfituese,paraqesin numrin e saktë të trojeve ndërtimore dhe këto dokumenta janë pjesë thelbësore e këtij vendimi.

II

Afati i shfrytëzimit të tokës komunale sipas këtij vendimi fillon nga plotfuqishmëria e të njëjtit dhe mbaron me kalimin e 40 viteve përkatësisht afatit të kontratës së shfrytëzimit.

III

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është:

Shkresa e QRK-Zyrës së Kryeministrit, Ref 163/10 e dt.06.04.2010,
Kërkesa e QRK-Ministrit për Komunitete dhe Kthim Nr.1264/2 e dt.23.05.2016 si dhe tërë dokumentacioni zyrtar që është në hyrje të këtij vendimi.

IV

Për implementimin e këtij vendimi kujdesët Kryetari i Komunës ndërsa zbatimin e drejtpërdrejt të projektit do ta bëjë Kompania përfituese e ndërtimit së bashku me Drejtorinë e Urbanizmit duke përcjell edhe realizimin e donacionit të Qeverisë së Republikës së Malit të Zi që i dedikohet këtij projekti.

Mbi bazë të vendimit të miratuar pas plotfuqishmërisë së tij në kuptim të nenit 20 paragrafi 8 dhe 9 të Rregullores së QRK nr.23/2013, të hartohet dhe nënshkruhet kontrata për dhënie në shfrytëzim afatgjatë prona e palujtëshme e komunës e cila me përsefermi përcakton kushtet –kriteret e shfrytëzimit të tokës komunale dhe e cila nënshkruhet nga kryetari i komunës dhe përfaqësuesi i institucionit qendror.

V

Vendimi është i plotfuqishëm me miratimin në Kuvendin e Komunës së Klinës dhe 15 ditë pas protokollimit në MAPL konform LVL si dhe shpalljes publike në të dy gjuhët zyrtare konform LVL dhe Rregullores së QRK nr.01/2013.

Me këtë vendim të njoftohen:

Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria për komunitete dhe Kthim,MAPL, Kryetarin e Komunës Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria e Urbanizmit dhe MM, , Drejtoria e Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronësisë në Klinë,Zyra Ligjore, Zyra për Informim, një kopje për Shërbimin për punë të Kuvendit dhe Arkivin e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS-KLINË

01Nr. 06-2734 /2016
Klinë, më 0106 /2016

